


Indeksi i Transparencës Buxhetore të Komunave **2021**



Përmbajtja

1.	Metodologjia	5
2.	Gjetjet kryesore për vitin 2021	7
3.	Krahasim: Indeksi 2021 me 2020	11
4.	Buxhetimi gjinor	13
5.	Përfundime dhe rekomandime	15

Lipjan	17
Mitrovica Jugore	18
Rahovec	19
Hani i Elezit	20
Drenas	21
Prishtina	22
Gjakovë	23
Gjilan	24
Klinë	25
Prizren	26
Kaçanik	27
Malishevë	28
Pejë	29
Obiliq	31
Vushtrri	32
Suharekë	33
Graçanicë	34
Istog	35
Dragash	36
Junik	37
Ferizaj	38
Skënderaj	39
Kamenicë	40
Viti	41
Mamushë	42
Shtime	43
Fushë Kosovë	44
Mitrovicë e Veriut	45
Novobërdë	46
Shtërpcë	47
Ranillug	48
Klllokot	49

Përmbledhje ekzekutive

Transparenca në procesin e buxhetimit rrit llogaridhënien dhe besimin në institucione publike, si dhe ndikon në menaxhim më efikas të parasë publike. Prandaj, publikimi i dokumenteve buxhetore me kohë dhe në formate lehtë të lexueshme ndikon në përfshirjen e qytetarëve dhe palëve të tjera të interesuara në proceset buxhetore. Për të gjitha këto arsye, Instituti GAP avokon për transparencë më të madhe buxhetore, duke inkurajuar komunat që të publikojnë të gjitha dokumentet buxhetore.

Për të gjashtin vit me radhë, Instituti GAP publikon Indeksin e Transparencë Buxhetore, i cili vlerëson komunat dhe i radhit ato në bazë të transparencës së treguar në publikimin e dokumenteve buxhetore dhe dëgjimet buxhetore të mbajtura me qytetarë. Në vitin 2021, transparenca buxhetore e komunave është në një nivel më të lartë se në vitet e kaluara. Komunat kanë publikuar 256 dokumente buxhetore dhe kanë organizuar 106 dëgjime buxhetore. Nga gjithsej 100 pikë të indeksit, rreth 65% e komunave kanë arritur të mbledhin mbi 50 pikë. Në indeksin buxhetor 2021, krahasuar me indeksin 2020, 17 komuna kanë treguar progres (11 më shumë se në indeksin paraprak), kurse 16 komuna kanë treguar regres (nëntë më pak se në vitin 2020). Progresin më të madh me pikë e kanë shënuar Komuna e Drenasit (+25 pikë), Mamushës (+23.5 pikë) dhe Komuna e Lipjanit (+20 pikë). Rritja e pikëve të mbledhura për këto tri komuna në indeksin e vitit 2021 vë në rezultat i rritjes së numrit të dokumenteve buxhetore të publikuara, dëgjimeve buxhetore të mbajtura dhe përmirësimit të formatit të publikimit. Ndërsa, sa i përket përqindjes së publikimit të dokumenteve të buxhetimit të përgjithshëm gjinor komunat e Kosovës kanë shënuar regres.

Në indeksin buxhetor 2021, dokumentet që janë publikuar nga më shumë komuna janë raporti financiar për tremujorin e dytë, Korniza Afatmesme Buxhetore (2022–2024) dhe raporti vjetor financiar. Dokumentet si 'buxheti i planifikuar për 2022' dhe 'raporti vjetor financiar 2021' janë dy dokumentet më së shpeshti të publikuara në format 'Excel', i cili mundëson lexim më të lehtë të të dhënave për palët tjera.

Nga 38 komuna, 18 prej tyre i kanë publikuar të gjitha dokumentet buxhetore që obligohen t'i publikojnë sipas Udhëzimit administrativ të MAPL-së për transparencë buxhetore në komuna. Në kërkesat e Institutit GAP për qasje në dokumentet buxhetore, 13 komuna nuk kanë kthyer përgjigje.

Bazuar në formatin e publikimit të dokumenteve buxhetore, komunat si Mitrovica e Jugut, Rahoveci dhe Lipjani janë komunat që të gjitha dokumentet buxhetore i kanë publikuar në 'Excel' ose 'Word'. Ndërsa, komunat si Deçani, Obiliqi dhe Drenasi janë komunat që shumicën nga dokumentet buxhetore në ueb-faqet e tyre i publikojnë në formatin 'dokument i skanuar' ose 'PDF', çfarë e bën më të vështirë përdorimin e informacioneve në këto dokumente nga qytetarët dhe organizatat monitoruese.

Metodologjia

Ngjashëm sikur në vitet e kaluara, edhe këtë vit, indeksi i transparencës buxhetore të komunave për vitin 2021 përbëhet nga gjithsej 100 pikë, të cilat janë shpërndarë në dokumentet buxhetore, rregulloret, listat e përfituesve të subvencioneve dhe dëgjimet publike buxhetore. Përveç dokumenteve të cilat duhet të publikohen sipas ligjit në fuqi, indeksi përmban edhe dokumente tjera të detajuara rreth shpenzimit të parasë publike nga ana e komunave të Kosovës, siç është Kartela Analitike e Kontos, dokument i cili ofron informata të detajuara për të gjitha transaksionet buxhetore të komunës brenda një viti. Numri i pikëve për secilin dokument dallon për nga rëndësia dhe është i njejtë për të gjitha komunat.

Tabela 1. Vlerësimi me pikë i komunave për publikimin e dokumenteve sipas Institutit GAP

Dokumenti	Excel/Word	PDF	Dokument i skanuar	Kërkesa
Raporti financiar TM 1 për vitin 2021	5	3.5	2.5	1.5
Raporti financiar TM 2 për vitin 2021	5	3.5	2.5	1.5
Raporti financiar TM 3 për vitin 2021	5	3.5	2.5	1.5
Raporti vjetor financiar për vitin 2021	15	10.5	7.5	4.5
Buxheti i planifikuar për vitin 2022	5	3.5	2.5	1.5
Rregullorja për ndarjen e subvencioneve	5	5	5	1.5
Lista e përfituesve të subvencioneve për vitin 2021	10	7	5	5
Kartela Analitike e Kontos për shpenzime të buxhetit për vitin 2021	20	14	10	10
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2021	2.5	2.5	2.5	2.5
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2021	2.5	2.5	2.5	2.5
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2021	2.5	2.5	2.5	2.5
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2021	2.5	2.5	2.5	2.5
Korniza Afatmesme Buxhetore 2022-2024	10	7	5	3
Kontratat e nënshkruara 2021	10	10	10	10

Të gjitha dokumentet që janë të publikuara në formatin më lehtë të lexueshëm, si Microsoft Excel apo Word, vlerësohen me numrin maksimal të pikëve me përjashtim të rregullores për subvencione dhe kontratave të nënshkruara me operatorët ekonomik, të cilat për shkak të përmbajtjes pothuajse tërësisht tekstuale, në secilin format marrin pikë të njëjta. Çdo dokument i publikuar në formatin PDF vlerësohet me 30% pikë më pak, ndërsa publikimi i dokumenteve të skanuara është vlerësuar me 50% pikë më pak.

Në rast se kemi ndonjë dokument buxhetor i cili nuk është publikuar në faqen zyrtare të komunës, mirëpo komuna është përgjigjur në kërkesën tonë dhe e ka dërguar atë përmes email-it, atëherë dokumenti është vlerësuar me 70% pikë më pak. Dokumentet si Kartela Analitike e Kontos, kontratat e nënshkruara dhe lista e përfituesve të subvencioneve edhe nëse dërgohen vetëm në kërkesë nuk i ulen pikët për 70% për shkak se këto dokumente ende nuk janë obligime ligjore për publikim. Nisur nga kjo, një komunë mund të vlerësohet me maksimumin e pikëve vetëm në rast se i ka publikuar të gjitha dokumentet në faqen e internetit në formatin 'Excel/Word' dhe ka organizuar të paktën katër dëgjime buxhetore.

Mbledhja e të dhënave për publikimin e dokumenteve është bërë duke kërkuar nga komunat që të plotësojnë një pyetësor me linqet/vegzat e dokumenteve të publikuara në faqen zyrtare të komunës. Kërkesa është dërguar në emailin zyrtar të komunës për komunikim me publikun gjatë muajit shtator 2022, ndërsa monitorimi i faqeve të komunave nga Instituti GAP ka përfunduar në muajin tetor 2022. Për secilën komunë që nuk është përgjigjur në kërkesën e Institutit GAP, vlerësimi i indeksit është bërë në bazë të informatave që kanë qenë të disponueshme në ueb-faqet e tyre. Në rastet kur një dokument nuk është gjetur në faqen e komunës me tri klikime dhe në fushën përkatëse të destinuar për raportet e buxhetit, atëherë nuk është marrë parasysh në vlerësim.

Bazuar në Ligjin për qasje në dokumente publike lejohet qasja në dokumente të cilat kanë të bëjnë me shpenzimin e parasë publike dhe nxiten institucionet që të publikojnë dokumentet në formatin elektronik, konkretisht në çfarëdo versioni që mundëson qasjen më të madhe të publikut. Përveç kësaj, ligji përmban pjesë për të dhëna të hapura dhe i obligon institucionet që në mënyrë proaktive të publikojnë çdo dokument publik të përfunduar, pavarësisht nëse qytetarët kanë bërë kërkesë për qasje në to ose jo. Për më shumë, institucionet duhet të publikojnë të dhëna të hapura që sipas ligjit duhet t'u mundësojnë qytetarëve përdorimin dhe krahasimin e të dhënave.¹

Në anën tjetër, udhëzimi administrativ i Ministrisë për Administrim të Pushtetit Lokal (MAPL) për transparencë në komuna, obligon komunat t'i publikojnë këto dokumente buxhetore: 1) planin e buxhetit dhe planet investuese; 2) raportet tre mujore të shpenzimeve; 3) kornizën afatmesme buxhetore (KAB); 4) raportin përmbledhës të buxhetit të komunës për vitin e kaluar fiskal; dhe 5) raportin e auditorit të përgjithshëm mbi buxhetin për vitin e kaluar fiskal.²

Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë i bën përgjegjës kryetarët e komunave për publikimin e raporteve tre mujore financiare të cilat duhet të publikohen në ueb-faqen e komunës, 30 ditë pas përfundimit të tremujorit të vitit³. Po ashtu, sipas këtij ligji, kuvendi komunal është i detyruar të mbajë dëgjime buxhetore me qytetarë në përputhje me aktet komunale. Kurse, udhëzimi administrativ i MAPL-së për transparencë në komuna përcakton se komunat përveç obligimit që t'i mbajnë të paktën dy dëgjime publike me qytetarë brenda vitit, duhet të organizojnë takime publike shtesë për buxhet dhe çështje tjera komunale.⁴ Po ashtu, në disa raste, qarkoret buxhetore të hartuara nga Ministria e Financave (MF) e obligojnë kryetar-in/ en e komunës që të shqyrtojë buxhetin me qytetarë.⁵

Nga 38 komuna, 25 prej tyre i janë përgjigjur pozitivisht kërkesave të Institutit GAP për qasje në dokumente. Gjatë procesit të monitorimit të faqeve të internetit të komunave, ka qenë sfiduese hapja dhe gjetja e dokumenteve buxhetore për disa nga komunat. Për hapjen e një dokumenti buxhetor nevojiteshin mesatarisht tre minuta. Ndërsa, në disa ueb-faqe të komunave, dokumentet buxhetore publikohen në kategori/fusha të cilat nuk janë të destinuara për dokumentet buxhetore apo dokumentet zyrtare në përgjithësi (shembull: raportet financiare tremujore dhe vjetore, buxheti i planifikuar, korniza afatmesme buxhetore tek kategoria e lajmeve).

¹ Ligji nr. 06/L-081 për qasje në dokumente publike. Burimi: <https://bit.ly/3A9JcMM>

² Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL). Udhëzim administrativ nr. 03/2020 për transparencë në komuna. Burimi: <https://bit.ly/3ElevHh>

³ Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Neni 45. Burimi: <http://bit.ly/2h3BfRW>

⁴ Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL). Udhëzim administrativ nr. 03/2020 për transparencë në komuna. Burimi: <https://bit.ly/3ElevHh>


⁵ Ibid.

Gjetjet kryesore për vitin 2021

Transparenca buxhetore e komunave në vitin 2021 është në një nivel më të lartë se në vitet e kaluara. Mesatarja e pikëve të Indeksit të Transparencës Buxhetore për të gjitha komunat për vitin 2021 është 53.1 pikë. Nga 38 komuna, 65% apo 25 prej tyre kanë kaluar nivelin mesatar të pikëve të indeksit (mbi 50 pikë). Maksimumin e pikëve të indeksit prej 100 pikë për vitin 2021 e kanë arritur tri komuna (Komuna e Mitrovicës së Jugut, Rahovecit dhe Lipjanit). Këto tri komuna kanë publikuar të gjitha dokumentet buxhetore në formatin 'Excel' ose 'Word', me përjashtim të dokumenteve me përmbajtje tekstuale që janë publikuar edhe në formate tjera si 'PDF' apo dokument të skanuar. Transparenca të lartë buxhetore në vitin 2021, bazuar në Indeksin e Institutit GAP, ka treguar edhe Komuna e Hanit të Elezit e cila ka mbledhur 95 pikë dhe e cila ka publikuar të gjitha dokumentet, mirëpo, për shkak të formatit të disa dokumenteve nuk ka marrë pikët maksimale. Ngjashëm edhe Komuna e Drenasit e cila është ranguar në vendin e pestë me 87.5 pikë.

Komunat e Zubin Potokut, Zveçanit, Parteshit dhe Leposaviqit janë vlerësuar me zero pikë në Indeks, meqenëse nuk kanë publikuar asnjë dokument dhe nuk janë përgjigjur në kërkesën e Institutit GAP për qasje në dokumentet buxhetore.

Figura 1. Indeksi për transparencë buxhetore komunale 2021



Leposaviqi / Partesh / Zubin Potoku / Zveçani 0

Figura 2. Indeksi për transparencë buxhetore komunale 2021 (e shfaqur në hartë)



Quartiles

- high
9 Municipalities
- medium high
10 Municipalities
- medium low
9 Municipalities
- low
10 Municipalities

Bazuar në Indeksin e Institutit GAP për Transparencë Buxhetore, komunat së bashku kanë publikuar 256 dokumente buxhetore (16 më pak se në vitin e kaluar) dhe kanë organizuar 106 dëgjime buxhetore (22 më shumë se vitin e kaluar). Numri më i madh i dokumenteve buxhetore (107 apo 55%) është publikuar në formatin 'Excel' ose 'Word', një pjesë tjetër më e vogël e dokumenteve buxhetore (53 apo 27%) janë publikuar në formatin 'dokument i skanuar', ndërsa në formatin 'PDF' janë publikuar 27 dokumente apo 14% e tyre. Ndërsa, pjesa tjetër e dokumenteve (5%) janë dërguar pas kërkesës së Institutit GAP për qasje në dokumente zyrtare.

Figura 3. Formati i dokumenteve buxhetore të publikuara



Tabela 2. Përqindja e komunave që kanë publikuar dokumentet që përmban indeksi

Dokumenti	% e publikimit nga komunat	Excel	PDF	Dokument i skanuar	Kërkesa
Raporti financiar TM 2 për vitin 2021	79%	47%	13%	37%	3%
Korniza Afatmesme Buxhetore 2022-2021	76%	41%	24%	28%	7%
Raporti vjetor financiar për vitin 2021	76%	76%	10%	10%	3%
Buxheti i planifikuar për vitin 2022	74%	75%	18%	4%	4%
Raporti financiar TM 1 për vitin 2021	74%	43%	18%	36%	4%
Raporti financiar TM 3 për vitin 2021	66%	48%	16%	32%	4%
Lista e përfituesve të subvencioneve për vitin 2021	53%	35%	5%	50%	10%
Kartela Analitike e Kontos për shpenzime të buxhetit për vitin 2021	18%	71%	14%	0%	14%
Rregullorja për ndarjen e subvencioneve	79%				
Kontratat e nënshkruara 2021	76%				
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2022	106 degjime buxhetore				

Në indeksin buxhetor 2021, dokumentet që janë publikuar nga më shumë komuna janë raporti financiar për tremujorin e dytë (TM2), Korniza Afatmesme Buxhetore (2022–2024) dhe raporti vjetor financiar. Ndërsa, Kartela Analitike e Kontos, si dokumenti buxhetor më i detajizuar është publikuar nga vetëm gjashtë komuna, ndërsa dy komuna e kanë përcjellur dokumentin përmes kërkesës zyrtare. Ndërsa, dokumentet si 'buxheti i planifikuar 2022' dhe 'raporti vjetor financiar 2021' janë dy dokumentet më së shpeshti të publikuara në format 'Excel', i cili mundëson lexim më të lehtë të të dhënave për palët tjera.

Tabela 3. Komunat që publikojnë më shumë nga dokumentet buxhetore në formatin Excel dhe ato në formatet PDF ose dokument i skanuar

Komuna	Excel/Word	Komuna	Dokument i skanuar
Mitrovica	90%	Deçani	100%
Rahoveci	90%	Obiliqi	78%
Lipjani	80%	Drenasi	60%

Sipas Udhëzimit administrativ të MAPL-së për transparencë në komuna, komunat në mënyrë sistematike obligohen të publikojnë raportet tre mujore dhe vjetore të buxhetit, planin e buxhetit për vitin e ardhshëm dhe Kornizën Afatmesme Buxhetore. Mirëpo, jo të gjitha komunat e zbatojnë këtë rregull. Më saktësisht, gjatë vitit 2021, janë vetëm 18 komuna që i kanë publikuar të gjitha këto dokumente buxhetore. Nga dokumentet buxhetore të kërkuara, 31 komuna kanë publikuar raportin financiar për tremujorin e dytë 2021, 29 komuna kanë publikuar raportin vjetor financiar 2021 dhe kornizën afatmesme buxhetore 2022 -2024, 28 komuna kanë publikuar buxhetin e planifikuar për vitin 2022. Për secilën nga këto dokumente janë mesatarisht nga 10 komuna të cilat nuk i kanë publikuar ato. Bazuar në formatin e publikimit të dokumenteve buxhetore, komunat e Deçanit, Obiliqit dhe Drenasit janë komunat që shumicën nga dokumentet buxhetore në ueb-faqet e tyre i publikojnë në formatin 'dokument i skanuar' ose 'PDF' çfarë e bën më të vështirë përdorimin e informacioneve në këto dokumente nga qytetarët. Ndërsa, Mitrovica e Jugut, Rahoveci dhe Lipjani janë komunat që të gjitha dokumentet buxhetore i kanë publikuar në formatet që u japin atyre pikë maksimale.

Tabela 4. Dokumentet e publikuara të indeksit për transparencë buxhetore komunale 2021

	Excel	PDF	Dokument i skanuar	Kërkesa
Raporti financiar TM 2 për vitin 2021	14	4	11	1
Rregullorja për ndarjen e subvencioneve	4	-	25	1
Kontratat e nënshkruara 2021	4	3	21	1
Korniza Afatmesme Buxhetore 2022–2021	12	7	8	2
Raporti vjetor financiar për vitin 2021	22	3	3	1
Buxheti i planifikuar për vitin 2022	22	3	2	1
Raporti financiar TM 1 për vitin 2021	12	5	10	1
Raporti financiar TM 3 për vitin 2021	13	3	8	1
Lista e përfituesve të subvencioneve për vitin 2021	7	1	10	2
Kartela Analitike e Kontos për shpenzime të buxhetit për vitin 2021	5	1	-	2

Krahasim: Indeksi 2021 me 2020

Vlerësimi dhe rangimi i komunave në Indeksin Buxhetor 2021 është realizuar njejtë sikurse vitet e kaluara. Në indeksin buxhetor 2021, krahasuar me indeksin 2020, 17 komuna kanë treguar progres (11 më shumë se në indeksin e kaluar). Kurse, 16 komuna kanë treguar regres (nëntë më pak se në vitin 2020). Pjesa mbetur e komunave nuk kanë pasur as progres as regres.

Progresin më të madh me pikë në vitin 2021 e kanë Komuna e Drenasit, e cila nga 62.5 pikë sa i kishte në vitin 2020, ka shkuar në 87.5 pikë (+25 pikë), Mamusha në Indeksin e vitit 2021 ka 23.5 pikë më shumë sesa në indeksin e vitit 2020 (nga 29 pikë ka shkuar në 49.5), si dhe Lipjani që në Indeksin e vitit 2021, merr pikë maksimale, përkatësisht 20 pikë më shumë sesa në indeksin e vitit 2020. Rritja e pikëve të mbledhura në Indeksin e vitit 2021 vie si rezultat i rritjes së numrit të dokumenteve buxhetore të publikuara, dëgjimeve buxhetore të mbajtura dhe/ose përmirësimit të formatit të publikimit.

Ndërsa komunat që kanë shënuar regres në transparencën buxhetore të vitit 2021 janë komunat që kanë publikuar më pak dokumente, në formate vështirë të lexueshme, apo kanë mbajtur më pak dëgjime buxhetore me qytetarë. Për shembull, Komuna e Shtimes ka marrë 31 pikë më pak krahasuar me Indeksin e vitit 2020, Komuna e Shtërpçës 27.5 pikë më pak dhe Komuna e Parteshit ka 15 pikë më pak (ka rënë në zero, pasi nuk ka publikuar asnjë dokument të vitit 2021).

Tabela 5. Numri i publikimit të dokumenteve dhe dëgjimeve buxhetore nga komunat

	2016	2017	2018	2019	2020	2021	Dallimi (2021-2020)
Raporti financiar TM 1 për vitin aktual	25	25	30	30	28	28	+3
Raporti financiar TM 2 për vitin aktual	25	27	29	29	29	30	+5
Raporti financiar TM 3 për vitin aktual	23	23	29	27	29	24	+1
Raporti vjetor financiar për vitin aktual	27	28	33	34	30	29	+2
Buxheti i planifikuar për vitin pasardhës	24	29	30	35	34	28	+4
Korniza Afatmesme Buxhetore	22	22	30	31	32	29	+7
Rregullorja për ndarjen e subvencioneve	23	28	30	33	32	30	+7
Lista e përfituesve të subvencioneve për vitin aktual	23	21	27	25	24	20	-3
Kartela Analitike e Kontos për shpenzime të buxhetit për vitin aktual	6	4	8	9	7	8	+2
Dëgjimet buxhetore me qytetarë për buxhetin e vitit pasardhës	87	91	109	121	84	106	+19

Që nga krijimi i Indeksit të GAP për Transparencë Buxhetore në vitin 2017, duke marrë për bazë vlerësimin e transparencës të vitit paraprak fiskal (2016), komunat tani kanë bërë hapa përpara në këtë aspekt. Në vitin 2021, krahas vitit 2016, përveç listës së përfituesve të subvencioneve, dokumentet e tjera të indeksit janë publikuar nga më shumë komuna.

Në tabelën lartë janë përfshirë dokumentet që janë marrë për bazë në gjashtë vitet në mënyrë që të jenë të krahasueshme. Edhe pse në vitin 2021, komunat kanë publikuar një numër më të vogël të dokumenteve buxhetore krahasuar me vitin 2020, mesatarja e pikëve për të gjitha komunat është më e lartë për shkak që numri i dëgjimeve buxhetore ka shënuar rritje. Ndërsa, krahasuar me vitin 2020, numri i komunave që kanë publikuar kartelën analitike të kontos në uebfaqen e tyre është një më pak. Në periudhë më afatgjatë (2016-2021) vërehet një trend i hapjes së komunave sa i përket mënyrës së publikimit të shpenzimeve të parasë publike dhe mbajtjes së takimeve për buxhet.

Tabela 6. Dallimi i komunave me progres më të madh dhe regres në rankimin e indeksit të transparencës buxhetore

Indeksi për transparencë buxhetore komunale	Pikët 2021	Rangimi 2021	Pikët 2020	Rangimi 2020	Dallimi në pikë 2020-2021	Dallimi në rangim 2020-2021
Lipjani	100	1	80	5	20	4 ▲
Rahoveci	100	1	82.5	4	17.5	3 ▲
Mitrovica	100	1	85	3	15	2 ▲
Hani i Elezit	95	4	100	1	-5	-3 ▼
Drenasi	87.5	5	62.5	14	25	9 ▲
Prishtina	75.5	6	74	7	1.5	1 ▲
Gjakova	72	7	78.5	6	-6.5	-1 ▼
Gjilani	70	8	70	9	0	1 ▲
Klina	70	8	62.5	14	7.5	6 ▲
Kaçaniku	67.5	10	62.5	14	5	4 ▲
Prizreni	67.5	10	63.5	13	4	3 ▲
Malisheva	66	12	51.5	22	14.5	10 ▲
Peja	65	13	68.5	11	-3.5	-2 ▼
Obiliqi	62.5	14	50.5	23	12	9 ▲
Podujeva	62.5	14	68.5	11	-6	-3 ▼
Graçanica	62.5	14	47.5	25	15	7 ▲
Vushtrria	62	17	69	10	-7	-6 ▼
Suhareka	61.5	18	55.5	20	6	3 ▲
Istogu	59.5	19	62	19	-2.5	0
Dragashi	58.5	20	72.5	8	-14	-12 ▼
Juniku	58.5	20	46.5	26	12	6 ▲
Ferizaj	58	22	42	27	16	5 ▲
Skënderaj	57.5	23	62.5	14	-5	-9 ▼
Kamenica	55.5	24	62.5	14	-7	-10 ▼
Shtimja	55	25	86	2	-31	-23 ▼
Vitia	52.5	26	52.5	21	0	-5 ▼
Mamusha	49.5	27	26	30	23.5	3 ▲
Deçani	45	28	50.5	23	-5.5	-5 ▼
Fushë Kosova	34.5	29	39.5	29	-5	0
Mitrovica e V.	30	30	25	31	5	1 ▲
Novobërda	27.5	31	10	35	17.5	4 ▲
Shtërpca	12.5	32	40	28	-27.5	-4 ▼
Ranilluga	8.5	33	12.5	34	-4	1 ▲
Klllokoti	7.5	34	20	32	-12.5	-2 ▼
Leposaviqi	0	35	0	36	0	-

Indeksi për transparencë buxhetore komunale	Pikët 2021	Rangimi 2021	Pikët 2020	Rangimi 2020	Dallimi në pikë 2020-2021	Dallimi në rangim 2020-2021
Zubin Potok	0	35	0	36	0	-
Zveçani	0	35	0	36	0	-
Parteshi	0	35	15	33	-15	-2 ▼

Buxhetimi gjinor

Bazuar në Ligjin Nr. 05/L-020 për barazi gjinore, institucionet e Kosovës janë "përgjegjëse për përfshirjen e buxhetimit gjinor në të gjitha fushat për të garantuar që parimi i barazisë gjinore të respektohet në mbledhjen, shpërndarjen dhe caktimin e burimeve".⁶ Me buxhetim gjinor kuptojmë integrimin gjinor në proceset buxhetore, që nënkupton vlerësimin e buxhetit në bazë të gjinisë në të gjitha nivelet e procesit buxhetor dhe mundëson alokimin më efikas të shpenzimeve publike duke ulur kështu pabarazinë gjinore brenda komunave.

Ministria e Financave lëshon qarkoret buxhetore me udhëzime për përgatitjen e buxhetit të Kosovës për vitin aktual dhe planifikimin e hershëm për tri vitet e ardhshme. Që nga viti 2018, në qarkore përfshihet edhe buxhetimi i përgjegjshëm gjinor sipas ligjit në fuqi ku organizatat duhet të bëjnë të dukshme efektet e shpenzimeve në barazinë gjinore në buxhetin vjetor, si dhe në qarkoret e brendshme buxhetore komunale si dokument bazë për planifikimin e buxhetit për tri vitet e ardhshme.⁷ Edhe pse buxhetimi gjinor nuk është futur në vlerësimin e komunave për transparencë buxhetore, Instituti GAP në këtë raport ka analizuar se sa nga komunat kanë të publikuara dokumente për buxhetim gjinor. Nga gjetjet e raportit del se vetëm 29% e komunave kanë publikuar dokumentet për buxhetimin e përgjegjshëm gjinor në krahasim me shifrën prej 42% sa ishte në vitin e kaluar. Pra, krahasuar me vitin paraprak 2020, gjatë vitit 2021, komunat e Kosovës kanë shënuar regres sa i përket përqindjes së publikimit të dokumenteve të buxhetimit të përgjegjshëm gjinor.

Tabela 7. Publikimi i dokumenteve për buxhetimin e përgjegjshëm gjinor nga komunat për vitin 2020 dhe 2021

Komunat	Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor 2020	Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor 2021
Deçan	✗	✓
Dragash	✓	✓
Drenas	✓	✓
Ferizaj	✓	✗
Fushë Kosovë	✗	✗
Gjakovë	✓	✓
Gjilan	✗	✗
Graçanicë	✗	✓
Hani i Elezit	✓	✗
Istog	✓	✗
Junik	✗	✓

⁶ Ligji nr. 05/L-020 për barazi gjinore. Burimi: <https://bit.ly/3SO9oGd>

⁷ Qarkorja buxhetore 2018/01. Burimi: <https://bit.ly/390PthV>

Komunat	Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor 2020	Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor 2021
Kaçanik	✓	✓
Kamenicë	✓	✗
Klinë	✗	✗
Klllokot	✗	✗
Leposaviq	✗	✗
Lipjan	✓	✓
Malishevë	✗	✗
Mamushë	✓	✗
Mitrovicë	✓	✓
Mitrovicë Veriore	✗	✗
Novobërdë	✗	✗
Obiliq	✓	✓
Partesh	✗	✗
Pejë	✗	✗
Podujevë	✓	✓
Prishtinë	✗	✗
Prizren	✗	✗
Rahovec	✗	✗
Ranillug	✗	✗
Shtërpcë	✗	✗
Shtime	✗	✓
Skënderaj	✓	✗
Suharekë	✓	✗
Viti	✓	✗
Vushtrri	✗	✗
Zubin Potok	✗	✗
Zveçan	✗	✗

Përfundime dhe rekomandime

Gjetjet e këtij raporti tregojnë se në vitin 2021, mesatarja e pikëve të indeksit për transparencë buxhetore është më e lartë se në vitin 2020. Në vitin 2021, krahas 2020, komunat kanë organizuar më shumë dëgjime buxhetore, mirëpo kanë publikuar një numër më vogël të dokumenteve buxhetore. Në periudhë më afatgjatë (2016–2021) vërehet një trend lëvizës i hapjes së komunave sa i përket mënyrës së publikimit të shpenzimeve të parasë publike dhe mbajtjes së takimeve për buxhet.

Në vitin 2021, 17 komuna apo 11 më shumë se në indeksin e kaluar kanë treguar progres. Ndërsa, 16 komuna kanë treguar regres, përkatësisht 10 më pak se në vitin 2020.

Përkundër obligimeve ligjore, një numër i konsiderueshëm i komunave vazhdojnë të mos i publikojnë dokumentet buxhetore siç kërkon legjislacioni në fuqi, konkretisht udhëzimi administrativ i MAPL për transparencë në komuna. Më saktësisht gjatë vitit 2021, vetëm 18 nga 38 komuna i kanë publikuar të gjitha këto dokumentet buxhetore.

Për të rritur transparencën buxhetore në komuna është e rëndësishme që:

- Komunat të publikojnë në afate të caktuara kohore dokumentet buxhetore;
- Komunat duhet t'i kushtojnë rëndësi edhe formatit në të cilin i publikojnë dokumentet buxhetore. Të njëjtat duhet të jenë publikuara në format të lexueshëm nga kompjuteri (për shembull Excel), në mënyrë që të ua lehtësojnë qytetarëve qasjen dhe përdorimin e të dhënave;
- MAPL duhet të monitorojë dhe nxisë implementimin e Udhëzimit Administrativ nr. 04/2018 për transparencë në komuna, konkretisht për të vlerësuar nëse janë duke u publikuar dokumentet e kërkuara buxhetore nga komunat, dhe nëse të njëjtat janë publikuar në bazë të fushave;
- Komunat duhet të angazhohen më shumë për të nxitur pjesëmarrjen e qytetarëve në dëgjime buxhetore dhe duhet të publikojnë procesverbalet e dëgjimeve buxhetore.

Anekset

Lipjan	17
Mitrovica Jugore	18
Rahovec	19
Hani i Elezit	20
Drenas	21
Prishtina	22
Gjakovë	23
Gjilan	24
Klinë	25
Prizren	26
Kaçanik	27
Malishevë	28
Pejë	29
Podujevë	30
Obiliq	31
Vushtrri	32
Suharekë	33
Graçanicë	34
Istog	35
Dragash	36
Junik	37
Ferizaj	38
Skënderaj	39
Kamenicë	40
Viti	41
Mamushë	42
Shtime	43
Fushë Kosovë	44
Mitrovicë e Veriut	45
Novobërdë	46
Shtërpcë	47
Ranillug	48
Klllokot	49

Lipjan

Bazuar në indeksin e Institutit GAP për transparencë buxhetore, Komuna e Lipjanit bën pjesë në kuartilin e lartë që në indeks marrin më shumë se 67.5 pikë dhe me 100 pikë të grumbulluara është renditur si komuna më transparente për vitin 2021, së bashku me komunën e Rahovecit dhe komunën e Mitrovicës së Jugut. Dokumentet buxhetore, Komuna e Lipjanit i ka publikuar në formatin 'Excel' ndërsa dokumentet me përmbajtje krejtsisht testuale i ka publikuar në formatin 'Word', që lejojnë qasje dhe përdorim të lehtë të të dhënave të publikuara. Ndërsa, të vetmet dokumente buxhetore që i ka publikuar në formatin 'Dokument i Skanuar' janë rregullorja për ndarjen e subvencioneve dhe kontratat e nënshkruara për vitin 2021. Po ashtu, Komuna e Lipjanit ka organizuar të paktën katër dëgjime buxhetore me qytetarët për buxhetin e vitit 2022.

Kjo komunë është përgjigjur në kërkesë për qasje në informacione konform Ligjit për qasje në dokumente publike.

Tabela 8. Vlerësimi i detajuar për të gjitha dokumentet buxhetore të Komunës së Lipjanit

Dokumenti	Excel/Word	PDF	Dokument i Skanuar	Kërkesa
Raporti financiar TM 1 për vitin 2021	5	0	0	0
Raporti financiar TM 2 për vitin 2021	5	0	0	0
Raporti financiar TM 3 për vitin 2021	5	0	0	0
Raporti vjetor financiar për vitin 2021	15	0	0	0
Buxheti i planifikuar për vitin 2022	5	0	0	0
Rregullorja për ndarjen e subvencioneve	0	0	5	0
Lista e përfituesve të subvencioneve për vitin 2021	10	0	0	0
Kartela Analitike e Kontos për shpenzime të buxhetit për vitin 2021	20	0	0	0
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2022	2.5	0	0	0
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2022	2.5	0	0	0
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2022	2.5	0	0	0
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2022	2.5	0	0	0
Korniza Afatmesme Buxhetore 2022-2024	10	0	0	0
Kontratat e nënshkruara 2021	0	0	10	0
TOTAL				100

Mitrovica Jugore

Në indeksin e Institutit GAP për transparencë buxhetore të komunave, Komuna e Mitrovicës së Jugut bën pjesë në kuartilin e lartë me maksimum pikë të fituara, duke u renditur kështu si komuna më transparente në Kosovë për vitin 2021, së bashku me Komunën e Rahovecit dhe Lipjanit. Të gjitha dokumentet e vlerësuara me pikë në indeks janë publikuar në faqen zyrtare të komunës dhe pothuajse të gjitha janë në formatin 'Excel/Word', i cili lejon qasje dhe përdorim të lehtë të të dhënave të publikuara. Komuna e Mitrovicës së Jugut ka publikuar rregullorën për subvencione në formatin 'Dokument i skanuar', por për shkak të përmbajtjes kryesisht tekstuale, ky dokument vlerësohet njëjtë në të gjitha formatet. Përndryshe, komuna gjithashtu ka organizuar të paktën katër dëgjime buxhetore me qytetarët për buxhetin e vitit 2022.

Kjo komunë është përgjigjur në kërkesë për qasje në informacione konform Ligjit për qasje në dokumente publike.

Tabela 9. Vlerësimi i detajuar për të gjitha dokumentet buxhetore të Komunës së Mitrovicës së Jugut

Dokumenti	Excel/Word	PDF	Dokument i Skanuar	Kërkesa
Raporti financiar TM 1 për vitin 2021	5	0	0	0
Raporti financiar TM 2 për vitin 2021	5	0	0	0
Raporti financiar TM 3 për vitin 2021	5	0	0	0
Raporti vjetor financiar për vitin 2021	15	0	0	0
Buxheti i planifikuar për vitin 2022	5	0	0	0
Rregullorja për ndarjen e subvencioneve	0	0	5	0
Lista e përfituesve të subvencioneve për vitin 2021	10	0	0	0
Kartela Analitike e Kontos për shpenzime të buxhetit për vitin 2021	20	0	0	0
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2022	2.5	0	0	0
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2022	2.5	0	0	0
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2022	2.5	0	0	0
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2022	2.5	0	0	0
Korniza Afatmesme Buxhetore 2022-2024	10	0	0	0
Kontratat e nënshkruara 2021	10	0	0	0
TOTAL				100

Rahovec

Komuna e Rahovecit së bashku me Komunën e Lipjanit dhe Mitrovicës së Jugut vlerësohen si komunat më transparente në Kosovë për vitin 2021. Të gjitha dokumentet e vlerësuara me pikë maksimale në indeks me përjashtim të rregullores për ndarjen e subvencioneve janë në formatin 'Excel/Word', i cili lejon qasje dhe përdorim të lehtë të të dhënave të publikuara. Përveç kësaj, në faqen zyrtare të saj Komuna e Rahovecit ka njoftuar për mbajtjen e të paktën katër dëgjimeve buxhetore me qytetarët për buxhetin e vitit 2022.

Kjo komunë është përgjigjur në kërkesë për qasje në informacione konform Ligjit për qasje në dokumente publike.

Tabela 10. Vlerësimi i detajuar për të gjitha dokumentet buxhetore të Komunës së Rahovecit

Dokumenti	Excel/Word	PDF	Dokument i	
			Skanuar	Kërkesa
Raporti financiar TM 1 për vitin 2021	5	0	0	0
Raporti financiar TM 2 për vitin 2021	5	0	0	0
Raporti financiar TM 3 për vitin 2021	5	0	0	0
Raporti vjetor financiar për vitin 2021	15	0	0	0
Buxheti i planifikuar për vitin 2022	5	0	0	0
Rregullorja për ndarjen e subvencioneve	0	0	5	0
Lista e përfituesve të subvencioneve për vitin 2021	10	0	0	0
Kartela Analitike e Kontos për shpenzime të buxhetit për vitin 2021	20	0	0	0
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2022	2.5	0	0	0
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2022	2.5	0	0	0
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2022	2.5	0	0	0
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2022	2.5	0	0	0
Korniza Afatmesme Buxhetore 2022-2024	10	0	0	0
Kontratat e nënshkruara 2021	10	0	0	0
TOTAL				100

Hani i Elezit

Bazuar në indeksin e GAP për transparencë buxhetore, komuna e Hanit të Elezit është ranguar si komuna e katërt më transparente për vitin 2021 me gjithsej 95 pikë të mbledhura. Të gjitha dokumentet e vlerësuara me pikë në indeks janë publikuar në faqen zyrtare të komunës dhe shumica prej tyre janë në formatin 'Excel/Word', i cili lejon qasje dhe përdorim të lehtë të të dhënave të publikuara. Në formatin 'Dokument i Skanuar', kjo komunë ka të publikuar rregulloren për ndarjen e subvencioneve, listën e përfituesëve të subvencioneve, si dhe kontratat e nënshkruara për vitin 2021. Po ashtu, komuna ka organizuar të paktën katër dëgjime buxhetore me qytetarët për buxhetin e vitit 2021.

Kjo komunë është përgjigjur në kërkesë për qasje në informacione konform Ligjit për qasje në dokumente publike.

Tabela 11. Vlerësimi i detajuar për të gjitha dokumentet buxhetore të Komunës së Hanit të Elezit

Dokumenti	Excel/Word	PDF	Dokument i Skanuar	Kërkesa
Raporti financiar TM 1 për vitin 2021	5	0	0	0
Raporti financiar TM 2 për vitin 2021	5	0	0	0
Raporti financiar TM 3 për vitin 2021	5	0	0	0
Raporti vjetor financiar për vitin 2021	15	0	0	0
Buxheti i planifikuar për vitin 2022	5	0	0	0
Rregullorja për ndarjen e subvencioneve	0	0	5	0
Lista e përfituesve të subvencioneve për vitin 2021	0	0	5	0
Kartela Analitike e Kontos për shpenzime të buxhetit për vitin 2021	20	0	0	0
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2022	0	0	2.5	0
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2022	0	0	2.5	0
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2022	0	0	2.5	0
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2022	0	0	2.5	0
Korniza Afatmesme Buxhetore 2022–2024	10	0	0	0
Kontratat e nënshkruara 2021	0	0	10	0
TOTAL				95

Drenas

Bazuar në Indeksin e GAP për transparencë buxhetore, Komuna e Drenasit është ranguar në pozitën e 5-të me gjithsej 87.5 pikë të mbledhura. Kjo komunë, për dallim prej vitit paraprak, listën për përfituesit e subvencioneve e ka të publikuar në formatin 'Excel/Word', gjë që mundëson qasje dhe përdorim të lehtë të të dhënave të publikuara. Përveç kësaj, në vitin 2021, Komuna e Drenasit ka publikuar edhe kartelën analitike të kontos për shpenzime të buxhetit e cila mungonte në vitin paraprak 2020, duke rritur kështu edhe numrin e pikëve të mbledhura në indeks. Gjithashtu, Komuna e Drenasit, ka njoftuar në faqen e saj zyrtare për mbajtjen e së paku katër dëgjimeve buxhetore me qytetarët për buxhetin e vitit 2022, si dhe ka bërë publike kontratat e nënshkruara.

Komuna e Drenasit është përgjigjur në kërkesë për qasje në informacione konform Ligjit për qasje në dokumente publike.

Tabela 12. Vlerësimi i detajuar për të gjitha dokumentet buxhetore të Komunës së Drenasit

Dokumenti	Excel/Word	PDF	Dokument i Skanuar	Kërkesa
Raporti financiar TM 1 për vitin 2021	0	0	2.5	0
Raporti financiar TM 2 për vitin 2021	0	0	2.5	0
Raporti financiar TM 3 për vitin 2021	0	0	2.5	0
Raporti vjetor financiar për vitin 2021	15	0	0	0
Buxheti i planifikuar për vitin 2022	5	0		0
Rregullorja për ndarjen e subvencioneve	0	0	5	0
Lista e përfituesve të subvencioneve për vitin 2021	10	0	0	0
Kartela Analitike e Kontos për shpenzime të buxhetit për vitin 2021	20	0	0	0
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2022	2.5	0	0	0
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2022	2.5	0	0	0
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2022	2.5	0	0	0
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2022	2.5	0	0	0
Korniza Afatmesme Buxhetore 2022-2024	0	0	5	0
Kontratat e nënshkruara 2021	0	0	10	0
TOTAL				87.5

Prishtina

Bazuar në indeksin e Institutit GAP për transparencë buxhetore, Komuna e Prishtinës me 75.5 pikë të fituara bën pjesë në kuartilin e lartë që në indeks marrin mbi 67.5 pikë dhe është renditur si komuna e 6-të më transparente për vitin 2021. Kryeqyteti i Kosovës, shumicën e dokumenteve buxhetore si: raportet financiare TM1, TM2 dhe TM3, listën e përfituesëve të subvencioneve dhe kornizën afatmesme buxhetore i ka publikuar në formatin 'Excel/Word' i cili lejon qasje dhe përdorim të lehtë të të dhënave të publikuara. Në formatin 'PDF' ka publikuar raportin vjetor financiar për vitin 2021, ndërsa në formatin 'Dokument i skanuar' ka të publikuar rregulloren për ndarjen e subvencioneve dhe kontratat e nënshkruara për vitin 2021. Ndërsa, në faqen e saj zyrtare në internet nuk e ka të publikuar kartelën analitike të kontos si një ndër dokumentet më të detajuara për shpenzimet buxhetore. Në faqen zyrtare të saj, Komuna e Prishtinës ka njoftuar për mbajtjen e së paku katër dëgjimeve buxhetore me qytetarët për buxhetin e vitit 2022.

Kjo komunë është përgjigjur në kërkesë për qasje në informacione konform Ligjit për qasje në dokumente publike.

Tabela 13. Vlerësimi i detajuar për të gjitha dokumentet buxhetore të Komunës së Prishtinës

Dokumenti	Excel/Word	PDF	Dokument i Skanuar	Kërkesa
Raporti financiar TM 1 për vitin 2021	5	0	0	0
Raporti financiar TM 2 për vitin 2021	5	0	0	0
Raporti financiar TM 3 për vitin 2021	5	0	0	0
Raporti vjetor financiar për vitin 2021	0	10.5	0	0
Buxheti i planifikuar për vitin 2022	5	0	0	0
Rregullorja për ndarjen e subvencioneve	0	0	5	0
Lista e përfituesve të subvencioneve për vitin 2021	10	0	0	0
Kartela Analitike e Kontos për shpenzime të buxhetit për vitin 2021	0	0	0	0
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2022	0	2.5	0	0
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2022	0	2.5	0	0
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2022	0	2.5	0	0
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2022	0	2.5	0	0
Korniza Afatmesme Buxhetore 2022–2024	10	0	0	0
Kontratat e nënshkruara 2021	0	0	10	0
TOTAL				75.5

Gjakovë

Bazuar në indeksin e Institutit GAP për transparencë buxhetore, me 72 pikë të fituara Komuna e Gjakovës bën pjesë në kuartilin e lartë që në indeks marrin më shumë se 67.5 pikë si dhe është renditur si komuna e 7-të në transparencë për vitin 2021. Kjo komunë raportet financiare për TM1, TM2, TM3, raportin vjetor financiar të vitit 2021, si dhe buxhetin e planifikuar për vitin 2022 i ka publikuar në formatin 'Excel/Word', i cili lejon qasje dhe përdorim të lehtë të të dhënave të publikuara. Ndërsa, në formatin 'PDF' ka publikuar kornizën afatmesme buxhetore dhe në formatin 'Dokument i skanuar' ka publikuar rregulloren për ndarjen e subvencioneve, listën e përfituesëve të subvencioneve për vitin 2021 dhe kontratat e nënshkruara. Komuna e Gjakovës ka njoftuar në faqen e zyrtare të saj për mbajtjen e së paku katër dëgjimeve buxhetore me qytetarët për buxhetin e vitit 2022, të cilat i ka të publikuara edhe në formatin 'Excel/Word'. Komuna e Gjakovës nuk e ka publikuar Kartelen Analitike të Kontos si një nga dokumentet më të detajuara për shpenzimet buxhetore.

Kjo komunë është përgjigjur në kërkesë për qasje në informacione konform Ligjit për qasje në dokumente publike.

Tabela 14. Vlerësimi i detajuar për të gjitha dokumentet buxhetore të Komunës së Gjakovës

Dokumenti	Excel/Word	PDF	Dokument i Skanuar	Kërkesa
Raporti financiar TM 1 për vitin 2021	5	0	0	0
Raporti financiar TM 2 për vitin 2021	5	0	0	0
Raporti financiar TM 3 për vitin 2021	5	0	0	0
Raporti vjetor financiar për vitin 2021	15	0	0	0
Buxheti i planifikuar për vitin 2022	5	0	0	0
Rregullorja për ndarjen e subvencioneve	0	0	5	0
Lista e përfituesve të subvencioneve për vitin 2021	0	0	5	0
Kartela Analitike e Kontos për shpenzime të buxhetit për vitin 2021	0	0	0	0
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2022	2.5	0	0	0
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2022	2.5	0	0	0
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2022	2.5	0	0	0
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2022	2.5	0	0	0
Korniza Afatmesme Buxhetore 2022–2024	0	7	0	0
Kontratat e nënshkruara 2021	0	0	10	
TOTAL				72

Gjilan

Komuna e Gjilanit bazuar në indeksin e Institutit GAP për transparencë buxhetore, bën pjesë në kuartilin e lartë që në indeks marrin mbi 67.5 pikë. Kjo komunë shumicen e dokumenteve buxhetore si: raportet financiare TM1, TM2 dhe TM3, raportin vjetror financiar për vitin 2021, buxhetin e planifikuar për vitin 2022, rregulloren për ndarjen e subvencioneve dhe kornizen afatmesme buxhetore 2022–2024 i ka publikuar në formatin 'Excel' ose 'Word' i cili lejon qasje dhe përdorim të lehtë të të dhënave të publikuara. Ndërsa, në formatin 'Dokument i skanuar' ka të publikuar kontratat e nënshkruara për vitin 2021. Përveç, kësaj Komuna e Gjilanit ka njoftuar në faqen zyrtare të saj për mbajtjen e së paku katër dëgjimeve buxhetore me qytetarët për buxhetin e vitit 2022, të cilat i ka të publikuara edhe në formatin 'Excel/Word'. Komuna e Gjilanit nuk e ka publikuar listën e përfituesve të subvencioneve për vitin 2021 dhe Kartelen Analitike të Kontos si një ndër dokumentet më të detajuara për shpenzimet buxhetore.

Kjo komunë është përgjigjur në kërkesë për qasje në informacione konform Ligjit për qasje në dokumente publike.

Tabela 15. Vlerësimi i detajuar për të gjitha dokumentet buxhetore të Komunës së Gjilanit

Dokumenti	Excel/Word	PDF	Dokument i Skanuar	Kërkesa
Raporti financiar TM 1 për vitin 2021	5	0	0	0
Raporti financiar TM 2 për vitin 2021	5	0	0	0
Raporti financiar TM 3 për vitin 2021	5	0	0	0
Raporti vjetor financiar për vitin 2021	15	0	0	0
Buxheti i planifikuar për vitin 2022	5	0	0	0
Rregullorja për ndarjen e subvencioneve	5	0	0	0
Lista e përfituesve të subvencioneve për vitin 2021	0	0	0	0
Kartela Analitike e Kontos për shpenzime të buxhetit për vitin 2021	0	0	0	0
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2022	2.5	0	0	0
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2022	2.5	0	0	0
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2022	2.5	0	0	0
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2022	2.5	0	0	0
Korniza Afatmesme Buxhetore 2022–2024	10	0	0	0
Kontratat e nënshkruara 2021	0	0	10	0
TOTAL				70

Klinë

Bazuar në indeksin e GAP për transparencë buxhetore, komuna e Klinës është ranguar si komuna e 8-të me gjithsej 70 pikë të mbledhura, duke bërë pjesë kështu në kuartilin e lartë. Kjo komunë, dokumentet buxhetore si: raporet financiare TM1 dhe TM2, buxhetin e planifikuar për vitin 2022, raportin vjetor financiar, si dhe kornizën afatmesme buxhetore i ka të publikuara në formatin 'Excel/Word' që lejon qasje dhe përdorim të lehtë të të dhënave të publikuara. Ndërsa, rregulloren për ndarjen e subvencioneve, listën e përfituesëve të subvencioneve, si dhe kontratat e nënshkruara për vitin 2021 i ka të publikuara në formatin 'Dokument i skanuar', gjë që e bën më të vështirë përdorimin e të dhënave të publikuara. Dokumenti buxhetor të cilin Komuna e Klinës nuk e ka publikuar gjatë vitit 2021 është kartela analitike e kontos për shpenzime të buxhetit, gjë që i zbret komunës 20 pikë në renditje. Gjithashtu, Komuna e Klinës ka njoftuar në faqen zyrtare të saj për mbajtjen e të paktën katër dëgjimeve buxhetor me qytetarët për buxhetin e vitit 2022.

Kjo komunë është përgjigjur në kërkesë për qasje në informacione konform Ligjit për qasje në dokumente publike.

Tabela 16. Vlerësimi i detajuar për të gjitha dokumentet buxhetore të Komunës së Klinës

Dokumenti	Excel/Word	PDF	Dokument i Skanuar	Kërkesa
Raporti financiar TM 1 për vitin 2021	0	0	0	0
Raporti financiar TM 2 për vitin 2021	5	0	0	0
Raporti financiar TM 3 për vitin 2021	5	0	0	0
Raporti vjetor financiar për vitin 2021	15	0	0	0
Buxheti i planifikuar për vitin 2022	5	0	0	0
Rregullorja për ndarjen e subvencioneve	0	0	5	0
Lista e përfituesve të subvencioneve për vitin 2021	0	0	5	0
Kartela Analitike e Kontos për shpenzime të buxhetit për vitin 2021	0	0	0	0
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2022	0	0	2.5	0
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2022	0	0	2.5	0
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2022	0	0	2.5	0
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2022	0	0	2.5	0
Korniza Afatmesme Buxhetore 2022–2024	10	0	0	0
Kontratat e nënshkruara 2021	0	0	10	0
TOTAL				70

Prizren

Bazuar në indeksin e GAP për transparencë buxhetore, komuna e Prizrenit është ranguar e 10-ta me gjithsej 67.5 pikë të mbledhura. Kjo komunë, dokumentet buxhetore si: Raportin financiar për TM1, TM2, TM3 si dhe listën e përfituesëve të subvencioneve e ka të publikuar në formatin 'PDF'. Raportin vjetor financiar dhe buxhetin e planifikuar për vitin 2022 e ka të publikuar në formatin 'Excel/Word'. Ndërsa, rregulloren për ndarjen e subvencioneve, kornizën afatmesme buxhetore dhe kontratat e nënshkruara i ka të publikuara në formatin 'Dokument i skanuar' që e bën më të vështirë përdorimin e këtyre të dhënave nga palët e interesuara. Komuna e Prizrenit ka njoftuar në faqen zyrtare të saj për mbajtjen e së paku katër dëgjimeve buxhetore. Ndërsa nuk ka publikuar fare kartelen analitike të kontos për shpenzimin e buxhetit.

Kjo komunë është përgjigjur në kërkesë për qasje në informacione konform Ligjit për qasje në dokumente publike.

Tabela 17. Vlerësimi i detajuar për të gjitha dokumentet buxhetore të Komunës së Prizrenit

Dokumenti	Excel/Word	PDF	Dokument i Skanuar	Kërkesa
Raporti financiar TM 1 për vitin 2021	0	3.5	0	0
Raporti financiar TM 2 për vitin 2021	0	3.5	0	0
Raporti financiar TM 3 për vitin 2021	0	3.5	0	0
Raporti vjetor financiar për vitin 2021	15	0	0	0
Buxheti i planifikuar për vitin 2022	5	0	0	0
Rregullorja për ndarjen e subvencioneve	0	0	5	0
Lista e përfituesve të subvencioneve për vitin 2021	0	7	0	0
Kartela Analitike e Kontos për shpenzime të buxhetit për vitin 2021	0	0	0	0
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2022	0	0	2.5	0
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2022	0	0	2.5	0
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2022	0	0	2.5	0
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2022	0	0	2.5	0
Korniza Afatmesme Buxhetore 2022-2024	0	0	5	0
Kontratat e nënshkruara 2021	0	0	10	0
TOTAL				67.5

Kaçanik

Komuna e Kaçanikut në indeksin për transparencë buxhetore bënë pjesë në kuartilin e mesëm të lartë që në indeks marrin 67.5 pikë apo më pak. Kjo komunë në faqen e saj zyrtare dokumentet sikurse raporti vjetor financiar për vitin 2021, buxheti i planifikuar për vitin 2022 dhe korniza afatmesme buxhetore 2022–2024 i ka publikuar në formatin excel/word. Kontratat e nënshkruara i ka publikuar në formatin PDF. Kurse, raportet financiare tremujore TM1, TM2 dhe TM3 të vitit 2021 i ka publikuar si dokumente të skanuara. Dokumentet e skanuara janë më vështirë për tu lexuar dhe analizuar nga përdoruesit, ndërsa publikimi i tyre në formatin word ose excel do mundësonte lexim dhe analizim me të lehtë të të dhenave të buxhetit. Komuna e Kaçanikut nuk ka publikuar dokumentin kartela analitike e kontos për shpenzime të buxhetit për vitin 2021 si një ndër dokumentet më të detajuar rreth shpenzimeve të buxhetit.

Kjo komunë i është përgjigjur kërkesës për qasje në dokumente buxhetore, konform Ligjit për qasje në dokumente zyrtare dhe ka mbajtur të paktën katër dëgjime buxhetore me qytetarë për buxhetin e vitit 2022.

Tabela 18. Vlerësimi i detajuar për të gjitha dokumentet buxhetore të Komunës së Kaçanikut

Dokumenti	Excel/Word	PDF	Dokument i skanuar	Kërkesa
Raporti financiar TM 1 për vitin 2021	0	0	2.5	0
Raporti financiar TM 2 për vitin 2021	0	0	2.5	0
Raporti financiar TM 3 për vitin 2021	0	0	2.5	0
Raporti vjetor financiar për vitin 2021	15	0	0	0
Buxheti i planifikuar për vitin 2022	5	0	0	0
Rregullorja për ndarjen e subvencioneve	0	0	5	0
Lista e përfituesve të subvencioneve për vitin 2021	0	0	5	0
Kartela Analitike e Kontos për shpenzime të buxhetit për vitin 2021	0	0	0	0
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2022	2.5	0	0	0
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2022	2.5	0	0	0
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2022	2.5	0	0	0
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2022	2.5	0	0	0
Korniza Afatmesme Buxhetore 2022–2024	10	0	0	0
Kontratat e nënshkruara 2021	0	10	0	0
TOTAL				67.5

Malishevë

